

**Përgjigje e Ankesës ndaj referatit për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët mësimore Farmakologji me Toksikologji, Hyrje në farmaci klinike, Farmakognozi, Bazat e farmakologjisë**

Ankesa ndaj referatit për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët mësimore Farmakologji me Toksikologji, Hyrje në farmaci klinike, Farmakognozi, Bazat e farmakologjisë u shqyrtua me kujdes nga anëtarët e Komisionit recenzues në përbërje: prof. dr. Ibrahim Ibraimi – kryetar, prof. dr. Agim Ramadani – anëtar dhe prof. dr. Nexhbedin Karemani – anëtar dhe Komisioni në fjalë e jep këtë Përgjigje në formë të raportit tekstual:

Ankesa e dorëzuar nga kandidati dr. sc. Bujar Qazimi nuk i plotëson elementet e duhura të Kundërshtimit i cili parashihet me nenin 79 dhe 80 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve dhe të asistent-doktorantëve në Universitetin Shtetëror të Tetovës nr. 02-3702/1 e datës 12.06.2014. Kjo për disa arsye:

- Ndaj referatit të Komisionit recenzues, **kandidati nuk ka të drejtë Ankesë por ka të drejtë Kundërshtimi**. Komisioni recenzues nuk sjellë Vendim por jep Propozim dhe prandaj, **në pajtim me nenin 79 të Rregullores së cituar më lartë, kandidati do të duhej të dorëzojë Kundërshtim ndaj referatit e jo Ankesë**.
- Në pajtim me nenin 80 të po të njëjtës Rregullore, **Kundërshtimi dorëzohet deri te Komisioni recenzues nëpërmjet dekanit të njësisë**. Kandidati Ankesën e tij e ka dorëzuar në Arkivin qendror të Universitetit të Tetovës që funksionon në kuadër të Rektoratit të Universitetit të Tetovës. Me këtë ka anashkuar Fakultetin e Shkencave Mjekësore.
- Kandidati Ankesën e tij e ka dorëzuar edhe në institucione tjera jashtë Universitetit të Tetovës, në kundërshtim me Rregulloren sipas së cilës në këtë fazë të Konkursit kandidati ka të drejtë Kundërshtimi vetëm deri te Komisioni recenzues. Duke mos dashur që kandidati t'ia mohojmë të drejtën t'iu drejtohet institucione tjera, kandidati është dashur që njëherë të merr përgjigjen nga Komisioni recenzues. Poashtu përpara se kandidati të

drejtohet në institucione tjera, duhet të harxhohen të gjitha mjetet juridike brenda Universitetit të Tetovës.

Por pa marrë parasysh këto që u thanë më lartë, Komisioni recenzues përsëri e shqyrtoi Ankesën e kandidatit dhe raporton si më poshtë:

- Kandidati dr. sc. Bujar Qazimi pretendon që Komisioni recenzues nuk ka përpiluar vlerësim me pikë tabelare. **Komisioni recenzues me përgjegjësinë më të plotë deklaron që shtojca tabelare ndaj referatit për zgjedhje është përpiluar në pajtim me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve dhe të asistent-doktorantëve në Universitetin Shtetëror të Tetovës nr. 02-3702/1 e datës 12.06.2014.** Shtojca tabelare është shpallur në Buletinin numër 128 të datës 26.03.2018. Në njoftimin e Buletinit të sipërpërmendur potencohet që Buletini mund të shikohet nga të interesuarit te Dekanët e Fakulteteve dhe në web faqen e Universitetit, dhe kandidati në çdo kohë ka mundur të kërkojë shikim publik të referatit.
- Kandidati më pas pretendon që në referat nuk janë publikuar të gjitha të dhënat për veprimtarinë e tij.  
Komisioni recenzues potencon që në referat është përmbledhur i gjithë dokumentacioni të cilin kandidati e ka dorëzuar në Konkurs.
- Kandidati poashtu pretendon që pikët e fituara të kandidatit të propozuar për t'u zgjedhur në thirrje mësimore-shkencore nuk janë të vlerësuara në mënyrë të rregullt.  
Ne si Komision recenzues deklarojmë që vlerësimi i pikëve është në përputhshmëri të plotë me Kriteriumet për vlerësimin e arritjeve të kandidatëve për zgjedhje në thirrje mësimore dhe në pajtim të plotë Rregulloren për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore. Kandidati i propozuar për zgjedhje në thirrje mësimore shkencore dr. sc. Qahil Ibraimi e plotëson numrin e duhur të pikëve për t'u zgjedhur në thirrjen mësimore-shkencore docent.

Komisioni recenzues, pas shqyrtimit të dosjes së kandidatit dr. sc. Qahil Ibraimi ka konstatuar se i njëjti është në marrëdhënie të rregullt të punës në Fakultetin e Shkencave Mjekësore në Universitetin e Tetovës që nga viti 2008 dhe me sukses e ka kryer veprimtarinë e tij mësimore për lëndët mësimore në fushën e farmakologjisë, toksikologjisë dhe farmakognozisë. Është në

marrëdhënie të rregullt të punës në Fakultetin e Shkencave Mjekësore për 10 vite dhe me këtë ka përparësi ndaj kandidatit tjetër i cili nuk ka të lidhur marrëdhënie të punës në Universitet. Poashtu, në pajtim me nenin 125 paragrafi 2 të Ligjit për arsimin e lartë të RM-së, kandidati dr. sc. Qahil Ibraimi ka të arritura në zbatimin e rezultateve hulumtuese dhe aftësi për kryerjen e llojeve të caktuara të veprimtarisë së arsimit të lartë.

### **PËRFUNDIM ME PROPOZIM**

Nga e gjithë kjo që u tha më lartë, Komisioni recenzues konsideron që Ankesa e kandidatit dr. sc. Bujar Qazimi, nr. 02-1609/1 e datës 06.04.2018 është e pabazë dhe në disa pjesë edhe tendencioze.

Komisioni recenzues në përbërje prof. dr. Ibrahim Ibraimi – kryetar, prof. dr. Agim Ramadani – anëtar dhe prof. dr. Nexhbedin Karemani – anëtar ka nderin e veçantë që edhe njëherë Këshillit të Rektoratit t'i propozojë që kandidati dr. sc. Qahil Ibraimi të zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore docent për lëndët mësimore Farmakologji me Toksikologji, Hyrje në farmaci klinike, Farmakognozi, Bazat e farmakologjisë.

Tetovë, 10.04.2018

Komisioni recenzues

Prof. dr. Ibrahim Ibraimi

Prof. dr. Agim Ramadani

Prof. dr. Nexhbedin Karemani